



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA PROFESIONALE "BEQIR ÇELA" DURRES

Nr. 500 prot

Data.20.11.2023

Lënda : Njoftim vënd vakant

Drejtuar: DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, i ndryshuar "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucionëve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit".

Ofruesi publik I AFP-Së, Shkolla e mesme profesionale "Beqir Çela", ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin/pozicionet:

1. Mësimdhënës të praktikës profesionale në drejtimin Shërbime Mjetesh Transporti - **4(katër) mësues.**
2. Mësimdhënës të praktikës profesionale në drejtimin Termohidraulikë – **1(një) mësues.**
3. Mësimdhënës të praktikës profesionale në drejtimin Teknologji Informacioni dhe Komunikimi TIK-**1(një) mësues.**

A - Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

1. Kriteret e përgjithshme:

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit e AFP-së duhet të përmbushë këto kriteret:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së, për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

B - Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

✓ Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

✓ Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda datës 05.12.2023.

Drejtori

Fatmir Merkuri

